



**MBI AKTIVITETIN
E KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR
DHE ZHVILLIMET NË REFORMËN
PËR MIRËQEVERISJEN, ANTIKORRUPSIONIN
DHE SUNDIMIN E LIGJIT**

**KPP – Buletin periodik 10
Mars-prill 2025**



**KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR
“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN
PËR SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**

Mars 2025

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit vijoi veprimtarinë e tij edhe gjatë muajit mars 2025, kryesisht me takime të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe konsultime të ndryshme për procesin e hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për tri shtyllat: *Mirëqeverisja, Antikorrupsioni dhe Sundimi i ligjit.*

5 mars 2025

Hartimi i Planit Kombëtar të Veprimit, ekspertët nisin konsultimet

Gjatë muajit mars 2025 Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë i atashuar pranë Komisionit të Posaçëm zhvilloi një proces të gjerë konsultimi me grupet e interesit, përfshirë institucionet shtetërore, agjencitë ekzekutive ligjzbatuese dhe ekspertë e konsulentë ndërkombëtarë, për hartimin dhe finalizimin e Planit Kombëtar të Veprimit.

Takimet u zhvilluan fillimisht në nivel teknik me institucionet shtetërore përgjegjëse për fushat respektive si dhe në tryeza diskutimi me përfaqësues të institucioneve të pavarura, të agjencive të ndryshme ekzekutive dhe grupeve të interesit, përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe të shoqërisë civile.

Në të njëjtën kohë u reflektuan vlerësimet, komentet dhe sugjerimet e dërguara nga 33 konsulentë të huaj dhe ata të diasporës të angazhuar në këtë proces si dhe nga 17 ekspertët e institucioneve ndërkombëtare të atashuar pranë Komisionit të Posaçëm për monitorimin dhe asistencën e tij.

Prill 2025

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit vijoi veprimtarinë e tij edhe gjatë muajit prill 2025, me organizimin Konferencës së II-të të Nivelit të Lartë “Shqipëria 2030 në BE - Rruga e Reformave”, ku u bë prezantimi i draftit të Planit Kombëtar të Veprimit për të tri shtyllat: *Mirëqeverisja, Antikorrupsioni dhe Sundimi i ligjit.*

3 prill 2025

Mbahet takimi i dytë i nivelit të lartë “Shqipëria 2030 në BE – Rruga e reformave”

Në aktivitet morën pjesë Kryetarja e Kuvendit, znj. Elisa Spiropali, Kryeministri, z. Edi Rama, z. Bjorn Berge, zëvendëssekretar i përgjithshëm i Këshillit të Europës, znj. Valentina Superti, drejtoreshë për Ballkanin Perëndimor në Komisionin European, përfaqësues të trupit diplomatik dhe të partnerëve ndërkombëtarë, ministra, deputetë, përfaqësues të institucioneve shtetërore,

agjencitë ligjzbatuese, shoqëria civile, ekspertë të nivelit të lartë të atashuar pranë Komisionit të Posaçëm etj. Takimi vijoi me zhvillimin e tri paneleve, ku u bë prezantimi i metodologjisë, gjetjeve dhe masave kryesore të parashikuara në draftin e Planit Kombëtar të Veprimit sipas të tri shtyllave objekt pune i Komisionit të Posaçëm: *Mirëqeverisjes, Antikorrupsionit dhe Sundimit të ligjit.*

3 prill 2025

Prezantohet Plani Kombëtar i Veprimit për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit

Pas fjalës përshëndetëse të Kryetares së Kuvendit, znj. Elisa Spiropali, Kryeministri Edi Rama, z. Bjorn Berge, zëvendëssekretar i përgjithshëm i Këshillit të Europës, znj. Valentina Superti, drejtoreshë për Ballkanin Perëndimor në Komisionin European, z. Aidan Eyakuze, drejtor ekzekutiv i Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP) dhe kryetari i Komisionit të Posaçëm, z. Fatmir Xhafaj, takimi i dytë i nivelit të lartë vijoi me tri panele diskutimi, ku u bë prezantimi i metodologjisë, gjetjeve dhe masave kryesore të parashikuara në draftin e Planit Kombëtar të Veprimit sipas të tri shtyllave objekt pune i Komisionit të Posaçëm: *Mirëqeverisjes, Antikorrupsionit dhe Sundimit të ligjit.*

Mirëqeverisja

Paneli i parë për shtyllën e Mirëqeverisjes u moderua nga znj. Milva Ekonomi, anëtare e Komisionit të Posaçëm, e cila vlerësoi punën e bërë nga ekspertët e nivelit të lartë dhe ata ndërkombëtarë për gjetjen e mekanizmave për integrimin e parimeve të OGP-së të transparencës, llogaridhënies, integritetit, rritjes së transparencës dhe angazhimit qytetar në proceset parlamentare.

Prezantimi i metodologjisë, i gjetjeve dhe masave kryesore të draftit të Planit Kombëtar të Veprimit për shtyllën “Mirëqeverisja” u bë nga prof. dr. Migena Leskoviku, prof. asoc. dr. Olta Milova dhe z. Geron Kamberi, të cilët paraqitën rekomandime konkrete lidhur me përmirësimin e kuadrit rregullator dhe legjislativ për transparencën në administratën publike, integritetin dhe etikën në administratën publike, rritjen e llogaridhënies së institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor, ofrimin e shërbimeve të digjitalizuara, rritjen e efektivitetit dhe transparencës në menaxhimin e financave publike, qeverisjen e hapur ku të mund të përfshihen më shumë elemente të mbikëqyrjes publike dhe llogaridhënies.

Z. Arbjan Mazniku, ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor, vlerësoi rëndësinë e rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së pushtetit lokal, forcimin e kapaciteteve institucionale në të gjitha nivelet me fokus te meritokracia dhe profesionalizmi, rritja e cilësisë së shërbimeve për qytetarët etj.

Më pas u vijua me prezantimin e gjetjeve të ekspertëve ndërkombëtarë dhe të diasporës lidhur me shtyllën e Mirëqeverisjes. Znj. Sandra Pernar, koordinatore

e OGP-së për Europën, prof. Francesco Tuçari nga Universiteti i Salentos dhe znj. Sabire Lici, eksperte nga diaspora, vlerësuan masat e propozuara për rritjen e transparencës dhe angazhimin qytetar në proceset parlamentare.

Takimi vijoi me diskutime dhe sugjerime të ftuarëve rreth masave të propozuara për shtyllën e Mirëqeverisjes.

Antikorrupsioni

Paneli i dytë për shtyllën “Antikorrupsioni” u moderua nga znj. Etilda Gjonaj, anëtare e Komisionit të Posaçëm, e cila parashtroi punën e bërë për procesin dhe konsultimin e gjatë me ekspertët ndërkombëtarë. Ajo theksoi rëndësinë e ndërmarrjes së një reforme të rëndësishme për luftën kundër korrupsionit, konsolidimin e shtetit të së drejtës, çka janë thelbësore për procesin e integritetit të vendit.

Prezantimi i metodologjisë, i gjetjeve dhe masave kryesore të draftit të Planit Kombëtar të Veprimit për shtyllën “Antikorrupsioni” u bë nga prof. asoc. dr. Jonida Rystemaj, prof. asoc. dr. Jonida Rystemaj, dr. Ardita Seknaj, dr. Ardita Seknaj, prof. asoc. dr. Ledjon Shahini. Grupi i ekspertëve prezantoi problematikat kryesore të identifikuar në sektorët që mbartin risk të lartë korrupsioni, si: pronat, prokurimet publike, shëndetësia, arsimit, doganat dhe tatimet. Ekspertët paraqitën propozime konkrete për zgjidhjen e këtyre problematikave, ku ndër të tjera u kërkua ndërhyrje për qartësimin dhe forcimin e sistemit të gjurmimit elektronik, përshtetimin e procesit të digjitalizimit të të dhënave kadastrale, përmirësime të mëtejshme në kuadrin ligjor për prokurimet publike, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, forcimin e kapaciteteve dhe rritjen e profesionalizimit të strukturave përgjegjëse, avancimin e procesit të digjitalizimit dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për tatimet dhe doganat, identifikimin dhe konfiskimin efektiv të aseteve të dyshimta, krijimin e Zyrës për Rikuperimin e Aseteve, zbatimin e ligjit “Antimafia” në fushën e taksave dhe tatimeve, përfshirjen e qytetarëve dhe të shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes dhe monitorimit të financave publike, integrimin në kurrikulat arsimore të edukimit kundër korrupsionit etj.

Znj. Adea Pirdeni, ministre e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, e pranishme në panel, vlerësoi punën e bërë nga të gjithë aktorët e përfshirë në hartimin e Planit të Veprimit, theksoi rëndësinë e qasjes proaktive dhe kontributit real në ndërtimin e një dokumenti që mbështet objektivin për integrimin e Shqipërisë, si dhe nënvizoi nevojën e ndërveprimit për të bërë të mundur që mekanizmat e mirëqeverisjes dhe të gjitha hallkat e luftës kundër korrupsionit të funksionojnë me efikasitet dhe të kontribuojnë realisht në ecurinë e negociatave me BE-në.

Takimi u përshëndet nga znj. Hanne Juncher, drejtore për Sigurinë, Integritetin dhe Sundimin e Ligjit në Këshillin e Europës, dhe dr. Robert Šumi, kryetar i Komisionit për Parandalimin e Korrupsionit në Slloveni, të cilët vlerësuan hapat

e ndërmarrë në luftën kundër korrupsionit, çka u konfirmua edhe në vendimmarrjen e GRECO-s, por dhe masat e ndërmarra në draftin e Planit të Veprimit.

Më tej u vijua me prezantimin nga ekspertët ndërkombëtarë dhe të diasporës, znj. Laura Stefan, eksperte e Këshillit të Europës, dr. Anna Corrado, gjyqtare administrative në Itali, prof. Michele Giuranno nga Universiteti i Salentos, dhe dr. Zamira Xhaferri, pedagoge pranë Universitetit të Amsterdemit, të cilët vlerësuan analizën kapilare të bërë nga ekspertët, ofruan përvojën e vendeve të tyre, si dhe paraqitën sugjerimet e tyre lidhur me përballimin e sfidave që lidhen me edukimin e shoqërisë, sektorin privat, luftën ndaj formave të ndryshme të korrupsionit etj.

Takimi vijoi me diskutime dhe sugjerime të të ftuarve rreth masave të propozuara në Planin e Veprimit.

Sundimi i ligjit

Paneli i tretë për shtyllën “Sundimi i ligjit” u moderua nga z. Toni Gogu, anëtar i Komisionit të Posaçëm, i cili vlerësoi punën profesionale të bërë nga ekspertët e GENL-së.

Prezantimi i metodologjisë, i gjetjeve dhe masave kryesore të parashikuara në Planin Kombëtar të Veprimit të shtyllës “Sundimi i ligjit” u bë nga prof. asoc. dr. Nadia Rusi dhe z. Gledis Gjipali, të cilët paraqitën gjetjen dhe sugjerimet e bëra nga ekspertët lidhur me përmirësimin e funksioneve të Kuvendit, transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit të tij, garantimit të të drejtave të njeriut si dhe fuqizimit të sundimit të ligjit në Shqipëri. Disa nga sugjerimet e ekspertëve për zgjidhjen e problematikave ishin: përmirësimi i kontrollit të lobimit përmes rritjes së eficiencës dhe transparencës; marrja e masave për të shmangur korrupsionin legjislativ; kalimi në një sistem plotësisht të integruar *e-Legjislacion*; rregullime për ushtrimin e së drejtës për peticionin; forcimi i mekanizmave për konsultimin publik të projektligjeve; rritja e përfshirjes efektive të shoqërisë civile në procesin legjislativ; përmirësimi i mekanizmave të kontrollit të zbatimit të ligjit; përmirësimi i cilësisë së ligjvënies; përmirësimi i rolit mbikëqyrës, koordinues dhe monitorues të Kuvendit, duke respektuar parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve etj.

Znj. Majlinda Dhuka, ministre e Shtetit dhe kryenegociatore e Shqipërisë në procesin e integritet europian, u ndal në disa elemente kyçe të lidhura me rolin e Kuvendit në fushën e sundimit të ligjit, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe udhëheqjen e procesit integruar të vendit.

Takimi vijoi me prezantimin nga prof. James A. Lofton, pedagog në Universitetin “Washington and Lee”, SHBA, dhe dr. Klodian Rado, pedagog në Universitetin “York”, Kanada, të cilët bënë një përmbledhje të gjetjeve dhe rekomandimeve

për Planin Kombëtar të Veprimit lidhur me shtyllën “Sundimi i ligjit” duke u fokusuar në garantimin e ndarjeve të pushteteve, pavarësinë e institucioneve të pavarura, rolin e Kuvendit në përmirësimin e sistemit të drejtësisë etj.

Takimi vijoi me diskutime dhe sugjerime të të ftuarëve lidhur me masat e propozuara nga ekspertët.

Planin Kombëtar të Veprimit mund ta gjeni në adresën e Komisionit të Posaçëm www.masl.al

Çfarë pritet të ndodhë gjatë muajit maj?

Plani Kombëtar i Veprimit për të tri shtyllat: *Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin e Sundimin e ligjit*, i cili përfshin 55 fusha tematike me mbi 250 masa specifike, nga të cilat propozohen mbi 70 nisma ligjore dhe rreth 180 masa institucionale, do t’i nënshtrohet procesit të konsultimit publik. Dokumenti do të konsultohet gjerësisht me ekipin e negociatorëve shqiptarë, ekspertë të fushave respektive të institucioneve të pavarura, të administratës publike, me shoqërinë civile dhe grupet e interesit, si dhe do t’i nënshtrohet ekspertizës së konsulentëve të huaj, përfshirë dhe disa nga institucionet e rëndësishme ndërkombëtare, si Këshilli i Europës, projekte të BE-së, të ambasadës franceze dhe asaj zvicerane, të Bankës Botërore, OSBE-së, USAID-it, NDI-së, OGP-së etj.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar



KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

**“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN PËR
SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**